



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01N/01.11.201-2252.6  
Dt: 16.11.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me formimin e komisionit për mbikëqyrjen e kontratës, me datë 16.11.2023 merr këtë:

### V E N D I M

1. Formohet komisioni për mbikëqyrjen e kontratës për shfrytëzimin e pronës komunale –me numër - 00008-1 dhe 00008-2 Z.K Gjakovë, në këtë përbërje:
  1. Albana Bakalli - Kryesuese e komisionit
  2. Dardane Riza, anëtare
  3. Bujar Nuqi, anëtar
2. Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të ndërmerre veprime konform legjislacionit në fuqi:
  - Të mbikëqyr realizimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës..
  - Të përgatitë raporte të rregullta gjashtë (6) mujore të monitorimit, realizimit të kontratës dhe ta dorëzojë në zyrën e Kryetarit.
  - Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, komisioni obligohet që në çdo kohë të njoftoj kryetarin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat tjera të përcaktuara në kontratë.
  - Të bëjë faturimin për çdo muaj dhe të njoftoj shfrytëzuesin për pagesë sipas kontratës.
  - Komisioni duhet të bëjë dorëzimin -pranimi e pronës komunale, më së largu 10 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

#### Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Gjakovës

